



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 878/10 prot.

Datë 22.04.2026

V E N D I M
Nr. 534/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.04.2026 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 457/2026, datë 02.04.2026 për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur e thjeshtuar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 24 (njëzet e katër) muaj”, me REF-78763-03-10-2026, me objekt: “Blerje Uniforma dhe veshje të tjera speciale”, me fond limit 9,932,756.67 (nëntë milion e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind pesëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 24.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “ASSANET” SHPK me Nipt. L41817014E dhe adresë: Rruga Nene Tereza ,pallati ngjit me Renerin Zona kadastrale 2066 me nr pasurie 129/760-N10, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Rruga “5 Maji”, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin

e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 02.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 457/2026, ku vendosi:

“[....]”

Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës e paraqitur nga operatori ekonomik “ASSANET” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 24 (njëzet e katër) muaj”, me REF-78763-03-10-2026, me objekt: “Blerje Uniforma dhe veshje të tjera speciale”, me fond limit 9,932,756.67 (nëntë milion e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind pesëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 24.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.

Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ASSANET” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 24 (njëzet e katër) muaj”, me REF-78763-03-10-2026, me objekt: “Blerje Uniforma dhe veshje të tjera speciale”, me fond limit 9,932,756.67 (nëntë milion e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind pesëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 24.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.

Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik dhe të KSHA-së, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.

Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi

Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ASSANET” SHPK.

Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.. [....]”

I.2. Me shkresën nr. 922/13 prot., datë 10.04.2026 me objekt “Dërgim Vendimi nr.457/2026, datë02.04.2026”, protokolluar me tonën nr. 878/7 prot., datë 16.04.2026, autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë, njofton se ka zbatuar vendimin Nr.457/2026, datë 02.04.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, duke i bashkëngjitur shkresës edhe shtojcën me modifikimet e dokumenteve të tenderit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 922/13 prot., datë 10.04.2026 me objekt “Dërgim Vendimi nr.457/2026, datë02.04.2026”, protokolluar me tonën nr. 878/7 prot., datë 16.04.2026, autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë, njofton se ka zbatuar vendimin Nr.457/2026, datë 02.04.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, duke i bashkëngjitur shkresës edhe shtojcën me modifikimet e dokumenteve të tenderit..

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se shtojca është publikuar në SPE.

Nga verifikimet në shtojcën e dërguar nga autoriteti kontraktor dhe publikuar në SPE, konstatohet se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin e KPP Nr. 457/2026, datë 02.04.2026.

II.2. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë e ka zbatuar vendimin vendimin 457/2026, datë 02.04.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë

së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 24 (njëzet e katër) muaj”, me REF-78763-03-10-2026, me objekt: “Blerje Uniforma dhe veshje të tjera speciale”, me fond limit 9,932,756.67 (nëntë milion e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind pesëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 24.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë..
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

